

L I G J
Nr.8329, datë 16.4.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7973, DATË 26.7.1995 "PËR KONCENSIONET
DHE PJESEMMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT NË SHËRBIMET PUBLIKE DHE
INFRASTRUKTURË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8105, DATË 28.3.1996 DHE
DEKRETIN NR.1628, DATË 17.10.1996**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", ndryshuar me ligjin nr.8105, datë 28.3.1996 dhe dekretin nr.1628, datë 17.10.1996, pas pikës 7 të nenit 3 shtohen pikat 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

"8. Zonat që kanë përparësi turizmin.

9. Sektori minerar."

Neni 2

Projektet në shërbimet publike apo infrastrukturë, që do të kontraktohen në sektorin privat për sektorët e përcaktuar në pikat 2,3,4,7,8 dhe 9 të nenit 3 miratohen nga Këshilli i Ministrave, ndërsa për sektorët e përcaktuar në pikat 1,5 dhe 6 të nenit 3 miratohen nga pushteti lokal.

Neni 3

Në nenin 9, pika 3, në marrëveshjet që hyjnë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi Popullor sipas pikave 2, 3, 4 dhe 7 të nenit 3, shtohen edhe pikat 8 e 9 të nenit 3.

Neni 4

Ky ligj hyj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2068, datë 23.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani